



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 58, DATË 05.08.2020

MBI

**NDRYSHIMIN E TË DHËNAVE TË PARAQITURA NË KËRKESËN PËR
MARRJEN E LICENCËS NGA SHOQËRIA "CHANNEL ONE" SH.P.K., PËR
NDRYSHIMIN E EMRIT NGA "TV CHANNEL ONE" NË "TV ORA NEWS"**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria "Channel One" sh.p.k.
Objekt: Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Channel One" sh.p.k. për ndryshimin e emrit të subjektit audioviziv nga "Tv Channel One", në "Tv Ora News".
Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 i ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

VËREN SE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive) me vendimin nr. 29/8, datë 30.10.2000, ka licencuar shoqërinë "Teknotrade LTD" sh.p.k., për subjektin audioviziv "Tv Tele 1". KKRT, me vendimet nr. 83, datë 31.10.2003 dhe nr. 772, datë 30.01.2009, ka rinovuar licencën e subjektit. AMA me vendimin nr. 117, datë 08.06.2016, ka rinovuar dhe zëvendësuar licencën shoqërisë "Channel One" sh.p.k.

Shoqëria "Channel One" sh.p.k., me shkresën nr. 3003 prot., datë 09.08.2019, ka paraqitur pranë AMA-s, kërkesën, nëpërmjet të cilës ka parashtruar se: "... Shoqëria "Channel One" sh.p.k., paraqet këtë kërkesë pranë institucionit tuaj për të ndryshuar emrin e subjektit nga TV Channel One në Tv ora News. Në lidhje me këtë kërkesë janë marrë vendimet përkatëse të asamblesë së aksionarëve të shoqërisë si dhe do të bëhen edhe ndryshimet përkatëse në Regjistrin tregtar të QKB pasi kjo të jetë konfirmuar edhe nga institucioni juaj...".

AMA me shkresën nr. 3003/1 prot., datë 15 gusht 2019, ka kërkuar nga subjekti, depozitimin e Certifikatës së Regjistrimit të logos apo markës, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave lidhur me përdorimin e emrit “Tv Ora News”.

Në vijim, shoqëria “Channel One” sh.p.k., me shkresën nr. 3003/2 prot., datë 02.09.2019, ka depozituar fotokopje të noterizuar me nr. 5957 rep., të datës 02.09.2019, të dëshmisë me nr. 648/1 prot., datë 18.07.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, për regjistrimin e markës “Tv Ora News”. Pasi është njohur me këtë shkresë, AMA ka rikërkuar depozitimin e Certifikatës së regjistrimit të markës për emrin “Ora News”, me pronar, shoqërinë “Channel One” sh.p.k.

Së fundmi, shoqëria “Channel One” sh.p.k., me shkresën nr. 2010 protokolli ynë, datë 21.07.2020, ka depozituar pranë AMA-s, Certifikatën për regjistrimin e markës “Ora News”, me nr. 649/10, datë 16.07.2020, për një periudhë 10 vjeçare, me numër regjistrimi 20776.

Rezulton se, shoqëria “Channel One” sh.p.k., ka kërkuar vetëm ndryshimin e emrit të subjektit jo të strukturës programore.

Në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesën për licencë/autorizim, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kryerjes së ndryshimeve. AMA konstaton se subjekti ka njoftuar mbi ndryshimet e ndodhura brenda afatit të përcaktuar ligjor.

Sa më sipër, AMA e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e subjektit, shoqërisë “Channel One” sh.p.k., për ndryshimin e emrit të shërbimit programor nga “Tv Channel One” në “TV Ora News”,

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqëria “Channel One” sh.p.k., duke ndryshuar emrin e shërbimit të programit audioviziv nga “Tv Channel One” në “Tv Ora News”.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA